

VENDIM
Nr. 745, datë 12.12.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 317, DATË 4.6.2025, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR
TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE
INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14/2, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nenin 6, të kreut II, të vendimit nr. 317, datë 4.6.2025, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 1, togfjalëshi “... deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë) ...” zëvendësohet me “... deri në 450 (katërqind e pesëdhjetë) ...”;

b) në shkronjën “a”, të pikës 2, togfjalëshi “... deri në 200 (dyqind) ...” zëvendësohet me “... deri në 350 (treqind e pesëdhjetë) ...”;

c) në shkronjën “b”, të pikës 2, togfjalëshi “... deri në 50 (pesëdhjetë) praktikantë ...” zëvendësohet me “... deri në 100 (njëqind) praktikantë ...”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për rininë, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe të gjitha institucionet e administratës publike të përfshira në program për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama